KOMUNA RAHOVEC

# BULETINI MUJOR KOMUNAL

## KORRIK 2020

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1046 Nr. i faq/Br.str/No.pg 105
Data/Datum/Date 10 / 08 / 2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

## PËRMBAJTJA

HYRJE ..... 2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE ..... 3
PËRFUNDIM ..... 16

## HYRJE

*Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.*

*Edhe muaji korrik i vitit 2020, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh, pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, situatë kjo e cila ka sjellur mjaft vështirësi edhe në Komunën e Rahovecit.*

*Me anë të këtij buletini mujor për muajin korrik, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet nga ana e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.*

## AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE

Kryetari, z.Smajl Latifi ka mbajtur Debatin e parë Publik për këtë vit me qytetarët e komunës së Rahovecit, në të cilin ka paraqitur angazhimin e tij dhe të qeverisë që drejton, si dhe projektet që janë realizuar për periudhën 6 mujore të vitit 2020.





Në komunën e Rahovecit, tashmë zyrtarisht ka filluar fushata e korrje- shirjeve, andaj, Kryetari, z.Smajl Latifi ka vizituar fermerët e komunës së Rahovecit dhe i ka uruar që të kenë rezultate më të mira, në mënyrë që sadopak t'ju shpërblehet djersa dhe mundi i punës së tyre.

Bashkë me Nënkryetarin, z.Fatmir Iska, drejtorin e DSHPS-së, z.Samir Mustafa dhe drejtorin e QKMF-së, z.Jusuf Korenica, Kryetari, z.Smajl Latifi ka par; nga afër ecurinë e punimeve që po kryhen në projektin: Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Emergjencës në Rahovec.



Kryetari Latifi ka zhvilluar një takim me znj.Bernandina Krasniqi- koordinatore e projektit: "Crimson Capital"- Implementimi i teknologjive të reja në serra, projekt ky i cili mbështetet nga USAID. Znj.Krasniqi ka sjellur në Komunën e Rahovecit, një Udhëzues për Kultivuesit e Serrave në Kosovë, e që së shpejti Komuna e Rahovecit do të organizojë një punëtori në bashkëpunim me USAID, punëtori kjo e cila do të mbahet me fermerët e komunës sonë, për informim më të hollësishëm, lidhur me përdorimin e këtij udhëzuesi nga fermerët tanë.





Së bashku me nënkryetarin dhe drejtorin e arsimit, Kryetari Latifi ka pritur në takim Ministrin e Arsimit, z.Ramë Likaj, deputeten znj.Tetuta Haxhiu dhe këshilltarin e ministrit z. Enver Osdautaj. Në takim u diskutua për mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet dy instuticioneve në fushën e arsimit, për sfidat me të cilat po përballet arsimi parauniversitar në kohën e pandemisë, ecurinë e zhvillimit të mësimit online dhe për mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve nga fusha e arsimit në komunën e Rahovecit.

Kryetari Latifi, së bashku me Nënkryetarin, z.Fatmir Iska kanë pritur në takim zëvendësministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Bajram Kastrati. Në takim u diskutua për kërkesën e komunës së Rahovecit që bujqit dhe fermerët të përfshihen edhe në pakon e rimëkëmbjes e natyrisht duhet të kompensohen edhe dëmet nga reshjet, si dhe për plot aspekte të tjera të cilat nëpërmes kësaj Ministrie, do të mund të zgjidhen.





Kryetari Latifi bashkë me kryetarët e komunave përmes platofrmës online kanë deabtuar me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti rreth situatës aktuale me pandeminë Covid-19.

Përuruam fushën sportive në Opterushë, një investim ky nga Komuna e Rahovecit, respektivisht DKRS, e cila do të shërbejë si pikë argëtimi, posaçërisht për nxënësit e mësimdhënësit e shkollës si dhe rinia e fshatit.





Komuna e Rahovecit, përfiton nga granti i performancës "Mjedisi i Pastër" në vlerë prej 106,223.00 euro.



Ka filluar rrënimi i objekteve pa leje në fshatin Krushë e Madhe. Pas ekspertizës së komisionit komunal i cili komision ka konstatuar se objekti në fjalë është i pashfrytëzueshëm dhe me rrezikshmëri të lartë për qytetarët. Rrënimi i objekteve të tilla krijon mundësi për investime të reja si në infrastrukturë publike ashtu edhe në mjedis.



Prezantimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021-2023, nga drejtori i DPF-së, z.Afrim Limani.



Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z.Afrim Limani gjatë dëgjimeve publike me qytetarët e komunës së Rahovecit për buxhetin e komunës së Rahovecit për vitin 2021.



Në kuadër të projektit për rregullimin e rrugëve fushore, ka filluar rregullimi i rrugës përballë hekurudhës, që i lidhë arat e fushës së Ratkocit, në pjesën që lidhet me fshatin Dejnë.



Pas insistimit dhe kërkesave të vazhdueshme nga Kryetari i Komunës z, Smajl Latifi për dëmshpërblim të fermerëve të komunës sonë, Qeveria e Kosovës me datë 05.07.2020 ka nxjerrur vendim që t'iu dal në ndihmë fermerëve të dëmtuar nga fondi rezervë për bujqësi.



Infrastruktura e kullimit të tokave bujqësore është një ndër faktorët kryesor me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor në vend. Punimet tek kanali i kullimit Ratkoc - Malësi e Vogël, ka bërë që shumë toka bujqësore të mbrohen nga përmbytjet e reshjeve të tepërta.

Asnjë vendbanim në Komunën e Rahovecit, nuk do të mbetet pa u trajtuar në kuadër të projektit "Rregullimi i rrugëve fushore". Punët për rregullimin e rrugëve fushore tani janë duke vazhduar në fshatin Gexhë, ku si pasojë e qasjes së vështirë të fermerëve, shumë toka bujqësore kanë mbetur pa u punuar. Në këto rrugë është duke u bërë pastrimi, zgjerimi dhe shtruarja me zhavor.





Shuma e fituar për dëmshpërblim të fermerëve të Komunës së Rahovecit nga breshri dhe vërshimet më 19 dhe 20 maj të këtij viti. Komuna e Rahovecit ka përfituar shumën më të lartë nga ky fond i Qeverisë së Republikës së Kosovës.



Rregullimi i infrastrukturës publike, konkretisht bujqësore është prioritet dhe detyrë e Qeverisë së drejtuar nga Kryetari z.Smajl Latifi, mbi këtë fakt tashmë kanë filluar punimet në rregullimin e rrugës fushore në Babindol nga Mulliri "Vetoni" në drejtim të fermës së Mullabazi-ëve. Drejtori i Bujqësisë z.Berat Duraku bashkë me drejtorin për Kadastër dhe Gjeodezi z. Afrim Oruqi kanë përcjellur nga afër edhe vendosjen e pikave gjeodezike për të kufizuar trasenë e kësaj rruge.



Edhe këtë vit Komuna e Rahovecit ka angazhuar kompani konsulente për plotësim të dokumenteve dhe hartim të projekteve për fermerë. Tanimë kompania është vendosur në objekt të komunës-zyra e legalizimeve dhe do t'i trajtojë të gjitha rastet e fermerëve që janë të interesuar të aplikojnë në skemën e granteve.



Kryetari, z. Smajl Latifi, bashkë me drejtoreshën për kulturë, rini dhe sport, znjsh. Bjondina Kleqka, pritën në takim të riun Ferat M Durguti, çiklist nga Rahoveci. Ferati këto vitet e fundit ka filluar të promovojë sportin e çiklizmit me ç' rast ka rrëmbyer disa medalje në gara kombëtare, e së shpejti pritet ta shohim të afirmohet edhe përtej kufinjve shtetëror. Në shenjë respekti Kryetari Latifi i ndau një mirënjohje si shenjë falënderimi dhe motivimi të mëtutjeshëm.

Kryetari, z.Smajl Latifi bashkë me drejtoreshën e DKRS-së, znjsh.Bjondina Kleqka kanë zhvilluar një takim pune me z. Bislim Zogaj, Drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.





Po vazhdojnë punimet në kuadër të projektit për "Riparim të Shtëpisë e Kulturës në Ratkoc". Punimet janë duke vazhduar me intensitet të shtuar dhe besojmë që shumë shpejt do përfundohen punimet në këtë objekt, i cili është shumë i rëndësishëm dhe i nevojshëm për të rinjtë, sidomos për komunitetin artistik.

Drejtoresha e DKRS-së, znjsh. Bjondina Kleqjasë bashku me stafin e drejtorisë, kanë vizituar punimet të cilët po zhvillohen në Dejnë, Ratkoc dhe Kramovik, projekte të cilët janë në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Investimi në infrastrukturë është i rëndësishëm, por më e rëndësishme është kultura, dhe të investohet tek të dyja, është më e mira që mund të kontribuojmë, meqënse hapësira të tilla rekreative sportive ndikojnë në masivizimin e pjesëmarrjes në sport dhe në shëndetin e njeriut.





Përurimi i fushës sportive në Kramovik. Në praninë e Kryetarit, z. Smajl Latifi dhe drejtorë të drejtorive komunale, është bërë përurimi i kësaj fushe. Ky investim i komunës së Rahovecit, përkatësisht i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, do të shërbejë për të rinjtë e fshatit Kramovik që të zhvillojnë aktivitete të ndryshme sportive në futboll, basketboll si dhe volejboll.

Drejtoresha e DKRS-së, znjsh.Bjondina Kleqka bashkë me ekipin punues dhe autoritetin përgjegjës mbikëqyrës, vizituan disa nga asetet e trashëgimisë kulturore-historike, vizituan objektet të cilat i janë nënshtruar intervenimeve konsvervuese dhe restauruese dhe një pjesë e tyre janë në proces të punimeve.



Zyrtarisht është pranuar investimi i bërë nga UNDP dhe Komuna e Rahovecit për trajtimin e një segmenti të ujërave fekale në fshatin Kramovik. Ky segment ishte i domosdoshëm për përfshirjen e 50 shtëpive ne trajtim të ujërave fekale dhe i cili trajtim u bë falë investimit të UNDP-së me participim edhe nga Komuna e Rahovecit, ku UNDP në vitin 2018 dhe 2019 kanë realizuar impiantin në Kramovik.





Është bërë debllokimi i kanalizimit fekal në fshatin Malësi e Vogël.

Kryetari, z.Smajl Latifi bashkë me drejtorin e DSHP-së, z. Përparim Krasniqi dhe qytetarë të shumtë të fshatit Nagac, kanë bërë përurimin e projektit të rrjetit të ndriçimit publik. Qytetarëve të Nagacit, në kuadër infrastrukturës i është shtuar tashmë edhe ndriçimi, që rrit edhe sigurinë e tyre. Ky projekt ka kushtuar 5.420.00 euro, ku janë përfshirë pesë rrugë të fshatit.





Vazhdon mirëmbajtja e rregullt e sipërfaqeve publike, sipas planit për mirëmbajtje.

Kanë filluar punimet në hapjen e një segmenti rrugor në fshatin Potoqan i Epërm. Për shkak terrenit të vështirë ky segment rrugor ka pamundësuar qarkullimin normal të qytetarëve.



Kryetari Latifi dhe drejtori i DSHP-së, z. Përparim Krasniqi bashkë me bashkëqytetarë të fshatit Dobidol kanë filluar vendosjen e ndriçimit publik në këtë fshat. Projekti i ndriçimit publik është i rëndësishëm për sigurinë e banorëve të kësaj zone. Përndryshe tash e tri vite komuna e Rahovecit ka punuar në shumë lokalitete në vendosjen e ndriçimeve publike, kryesisht në rrugët kryesore, dhe do të vazhdojmë ndriçimin publik, sipas prioriteteve, në Rahovec si dhe në vendbanime të tjera të komunës.



Kryetari i komunës z.Smajl Latifi dhe drejtori i DKA-së z.Avni Morina, sot kanë pritur në takim menaxherin për Kosovë të Caritasit Zviceran, z.Albert Bakalli dhe menaxheren nga kjo organizatë, znj. Krenare Lleshi.Në takim u nënshkrua marrëveshja në kuadër të projektit "SHPRESË", qëllimi i së cilës është përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe ofrimit të shërbimit në arsimin parafillor (APF), duke përfshirë edhe punën me edukatorët para-shërbimit dhe atyre që janë duke punuar, si dhe institucionet e tjera lokale relevante.





Po vazhdon furnizimi me dru i shkollave. Pamje tek oborri i Shkollës së Mesme Profesionale "Selajdin Mullabazi-Mici" – Rahovec.

Po vazhdojnë punimet në ndërtimin e çerdhes për fëmijë në Ratkoc. Drejtori i DKA-së, z.Avni Morina ishte për vizitë aty dhe pa se po punohet në lyerjen (suvatimin) e mureve të brendshme të ndërtesës. Më pastaj do të vazhdohet me fasadim.





Ka filluar puna në instalimin e ngrohjes qendrore në Shfmu "Vëllezërit Frashëri" - paralelja e ndarë në Senoc. Në këtë objekt shkollor dhe në objektin e Shfmu "Dëshmorët e Lirisë" në Pataqan të Poshtëm, do të instalohet ngrohja qendrore.

Vazhdojnë punimet në efiçiencë të energjisë në shkollën "Nesimi Elshani" në Nagavc. Pas instalimit të ndriçimit efiçient dhe montimit të dyerve dhe dritareve, kanë filluar punët në izolimin e kulmit dhe ka filluar instalimi i ngrohjes qendrore.





Po vazhdojnë punimet për ndërtimin e shtegut të ecjes "LULET E MARSIT", në Krushë të Madhe.

Drejtori i DEZHT-së, z.Artan Asllani, ka vizituar biznesin "Frigo Star" me pronar z.Sinan Ejupi, vizita është bërë me qëllim të njoftimit se tashmë komuna e Rahovecit, ka angazhuar një kompani për vlerësimin e dëmeve të bizneseve gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Ai poashtu e informoi pronarin e kompanisë "Frigo Star" për lehtësirat që ka krijuar komuna e Rahovecit gjatë kësaj periudhe të vështirë për bizneset ku me anë të vendimit të Kuvendit Komunal Rahovec, bizneset janë liruar nga qiraja dhe taksa afariste komunale për periudhën tremujore mars-maj 2020.





Drejtori i DUPMM-së, z. Rumir Zhuniqi, bashkë me kryetarin e Zaqishtit, Enver Kabashi, panë nga afër hapësirën në mes të fshatit që dalëngadalë po merr pamjen e parkut. Punimet do të përfundojnë së shpejti dhe banorët e Zaqishtit do ta kenë një vend më shumë për të kaluar kohën e lirë në ambient të hapur.



Drejtori i DUPMM-së, z. Rumir Zhuniqi, bashkë me drejtorin e DBPZHR-së, z.Berat Duraku, vizituan Brestocin, Nagafcin e Krushën e Madhe, ku po vazhdon ndërtimi i shtretërve të lumenjve në këto vendbanime.



Kryetari, z.Smajl Latifi ka pritur në një takim miqësor kryetarin e Mamushës, Abdulhadi Krasniqi, me të cilin bashkëbiseduan rreth situatës aktuale dhe sfidat me të cilat po përballemi gjatë pandemisë COVID-19, me theks të veçantë në sektorin e bujqësisë, e posaçërisht për dëmet që ka shkaktuar breshëri në Rahovec dhe Mamushë.

Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë dhe qytetarë të shumtë të fshatit Opterushë, kanë vënë gurthemelin e Qendrës së Mjekësisë Familjare. Projekti në fjalë është investim i Komunës së Rahovecit dhe kap vlerën prej: 81.543, 22€. Me vënien e gurthemelit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Opterushë, po bëhet edhe një hap tjetër drejt ofrimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët në vendet ku ata jetojnë.





Me rastin e 22 vjetorit të shënimit të "Epopesë së Korrikut 1998", Kryetari, z.Smajl Latifi me bashkëluftëtarë, bashkëpunëtorë dhe familjarë të të rënëve, kanë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Rahovec, te shtatorja e heronjve Toni dhe Mici, si dhe te Muri i Pikëllimit, aty ku rrezatojnë dëshmorët, Abdullah Bugari dhe Gëzim Hamza-Piktori-Rahovec, si dhe martirët e lirisë.

Me rastin e 22 vjetorit të shënimit të "Epopesë së Korrikut 1998", Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, bashkëluftëtarë e miq, nderuan sakrificën për liri, shpalosën dëshmi të kujtesës historike përmes pllakave modeste të mermerit në shtëpitë baza të veprimtarisë çlirimtare.





Me përulje dhe nderim, u kujtuan bijtë më të mirë që ka dhënë Rahoveci me rrethinë në Epopenë e Korrikut 1998. Me nderimin e dëshmorëve të atdheut Gani Paqarizi, Agim Kelmendi dhe Tafil Zyberaj në Fortesë, kujtojmë Epopenë e Korrikut në Fortesë.



Në praninë e bashkëluftëtarëve, familjarëve të dëshmorëve dhe qytetarëve, u shënua 22- vjetori i përjetësimit, te lapidari i dëshmorëve të atdheut: Agim Çelaj-Pejë, Sadik Shala-Kleçkë (Malishevë), Hamdi Berisha-Gurbardh(Malishevë), Bajram Veliu-Rahovec, Afrim Krasniqi-Bardh (Malishevë), Liman Gegaj-Fshati i Ri (Malishevë),Faik Rama-Rahovec. Gjithashtu, u shënua me nderime dhe homazhe edhe përvjetori i hyrjes në pavdekësi i luftëtarit të njohur, dëshmorit të kombit Gëzim Hamza-Piktori.

Në 22 vjetorin e rënies, Kryetari, z.Smajl Latifi me bashkëluftëtarë, miq e familjarë, kanë bërë homazhe para Shtatores së Heroit të Kosovës pranë Teqesë së Madhe të Halvetive në Rahovec, që të nderojnë një figurë të ndritur të historisë së Rahovecit, prijësin fetar dhe atdhetarin, Shejh Myhedin Shehun, i cili u vra nga dora barbare e pushtuesit serb.



Me rastin e 22 vjetorit të kujtimit të sakrificës së dëshmorëve, me bashkëluftëtarë, bashkëpunëtorë, familjarë të të rënëve për liri, kanë bërë nderime dhe homazhe te “Maja e Shkodranit” dhe Lapidari i dëshmorëve në Rahovec.21 korriku i vitit 1998, për ne dhe brezat pas nesh, është edhe një dëshmi e një faqeje lavdie e historisë e shkruar me gjak trimash. Rezistencës deri në vetëmohim të bashkëluftëtarëve të UÇK-së i dhanë kuptim Mizahir Isma, Eshrefedin Kastrati, Arian Brahimi-Shkodrani, Bekim Isma. Janë djemtë e bashkuar që u besatuan për të qëndruar stoikisht në pozicione të luftës e të nderit, deri në fund.





I shoqëruar nga drejtori i DBZHR-së, z.Berat Duraku, Kryetari Latifi ka vizituar zyret e vendit në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, aty ku fermerët e zonës tashmë për herë të dytë po aplikojnë për subvencione të Ministrisë së Bujqësisë. Task Forca e Drejtorisë së Bujqësisë është në dispozicion të fermerëve të komunës së Rahovecit për procedurat e aplikimit, poashtu njëjtë sikurse edhe vitin e kaluar Komuna e Rahovecit i ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që ky proces të përfundojë sa më mirë për fermerët tanë.



Kryetari, z.Smajl Latifi bashkë me drejtorin e Bujqësisë, z.Berat Duraku, kanë vizituar punimet për rregullimin e rrugëve fushore në fshatin Fortesë. Nisur nga fakti se rajoni i Rahovecit varet kryekëput nga bujqësia, investimet në këto rrugë fushash janë ndër faktorët me rëndësi për mirëqenien e bujqve të kësaj ane. Rregullimi i rrugëve fushore, fermerëve do t'ju mundësojë qasje më të lehtë për kryerjen e punëve agroteknike.



Me rastin e pensionimit të z.Ruzhdi Kabashi, Kryetari, z.Smajl Latifi bashkë me nënkryetarin Iska dhe drejtorin e DGJK-së Afrim Oruqi, Ruzhdiut i kanë ndarë një mirënjohje në shenjë respekti për kontributin e dhënë për 45 vjet si gjeodet në komunën e Rahovecit.

## PËRFUNDIM

*Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe:*

*(korrik 2020).*

*Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t`iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.*

*Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.*

*Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.*

*Vërejtje: Lista e vendimeve të marra nga ana e Kryetarit të Komunës, do të publikohet , veçmas dhe të gjitha vendimet e listuara, mund t'i gjeni në ueb faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.*

*Rahovec, gusht 2020*